

PINA VATA

FRAZELOGJIA NË VEPRËN E AT ZEF PLLUMIT

Vepra “Rrno vetëm për me tregue” e At Zef Pllumit nuk është produkt i përpjekjes së autorit për të paraqitur artistikisht realitetin e hidhur shqiptar gjatë viteve të diktaturës. Kjo vepër lindi vetëm nga vullneti i autorit për të na përcjellë këto vite sa më realisht. Frazelogjia është aspekti ku mund të shihet më mirë jo vetëm mendësia dhe shpirti krijues i autorit, por edhe i të gjithë popullit. Sipas psikolinguistit Raymond Gibbs, profesor dhe kërkues shkencor në Universitetin e Kalifornisë (Santa Kruz): “Shprehjet frazeologjike përmbajnë më shumë kuptim se çdo ekuivalent i tyre që mund ta parafranojë tekstin. Ato përcjellin jo vetëm kuptimin parësor të fjalës, por edhe sugjerojnë njëkohësisht shumë nënkuptime, më shumë se ç’mund të bëjë një fjalë apo disa fjali”.

Frazelogjia më tepër se çdo fushë tjetër e gjuhës lidhet me kulturën dhe me traditën e një populli, sepse njësitet bazë të saj, frazemat, lidhen me kontekstin shoqëror, kjo ngaqë ato emërtojnë koncepte, dukuri e sende të cilat lidhen me njeriun, me natyrën, me botën e tij shpirtërore dhe intelektuale

Njësitet frazeologjike të përdorura nga një popull i caktuar e bëjnë më të dallueshme gjuhën e këtij populli duke e formësuar njëkohësisht atë.

Vepra e At Zef Pllumit nuk është një vepër e mirëfilltë letrare, por nuk i mungojnë frazeologjitë. Sipas Gibbs: “Shprehjet frazeologjike kanë kuptime komplekse që duket të jenë të motivuara në mënyrë të pavarur nga metaforat e gjalla dhe janë në gjendje të reflektojnë kompleksitetin e mendimeve humane më mirë se çdo fjalë e vetme”. Prandaj, Gibbs refuzon supozimin se idiomat janë metafora të vdekur. Sipas tij shumë metafora konceptuale themelore janë shprehje pothuajse ideale që përmbledhin stereotipet dhe përvojat e përsëritura të eksperiencës njerëzore. Si të tilla ato luajnë një rol të veçantë në veprën e At Zef Pllumit: “Rrno vetëm për me tregue”, ato vijnë si reaksion përnjëhershëm i realitetit, duke përçarur kështu përmes frazeologjisë, frymën popullore. Vepra “Rrno vetëm për me tregue” krahas vlerave biografike ka edhe vlera artistike të vërteta dhe në këtë mes larmia e gjuhës dhe koloriti frazeologjik shtojnë forcën e tyre ndikuese. Frazelogjitë e marra nga ligjërimi popullor janë të strukturave të ndryshme. Ka ndër to krahasime metaforike me shprehësi të lartë në kontekstin ku gjenden. Realiteti që jetoi autori nuk mund të përcillej nga asgjë më mirë se nga frazeologjia e cila shpesh del jashtë kontekstit fillestar për t’iu përshtatur realitetit të krijuar. Studiuesi Ronald Carter, i Shkollës Strukturaliste Funksionale të Pragës, sugjeron se “njësitet frazeologjike jo vetëm lehtësojnë komunikimin e fenomeneve stereotipe dhe luajnë një rol të madh në mbajtjen stabël të komunikimit, por edhe shërbejnë si bazë për ndërtime të reja me forcë më të madhe shprehëse dhe njohëse”. Pra kush më shumë se At Zef Pllumi, njeri i letrave, njohës i jetës së

popullit dhe pasurisë së tij gjuhësore, në Shqipëri, në kushtet e mungesës totale të lirisë së fjalës, kishte nevojë të përdorte gjuhën e figurshme të popullit për t'u kuptuar prej tij. Në fund kjo është praktikë e françeskanëve shqiptarë, po të kemi parasysh Fishtën, që zgjodhi ta bënte të njohur "Lahutën e Malsisë" nëpërmjet këngës së popullit, traditës së tij gojore.

Si në të gjithë gjuhën shqipe edhe në veprën e At Zef Pllumit njësitë frazeologjike kanë strukturën e togfjalëshit ose të një fjalie.

Njësitë frazeologjike me strukturë togfjalëshi, sipas kategorisë leksiko-gramatikore të gjymtyrëve që e përbëjnë janë disa llojesh:

Emër + emër: *Të zitë e ullinit; i hunit e litari; pikë e vner; si qeni në rrush; një sy gjumë; si djalli i fundiferrit; e mbramja birë e kavallit; akull një copet; babë e mbi babë; ombrellën e lirisë; si krypa në ujë; copë e zhel; në breg të votrës; turp e faqe e zeze; si berrat te kasapi; në dritë të synit; gazi i dheut; në dritë të synit etj.*

Emër + mbiemër: *fukara i këputun; i rrahun në jetë; por edhe me rend të kundërt: kangëtar i lindun; i veshun e mathun si krajl; i djegun për ujë; ose gjejmë edhe frazeologji me strukturë emër + peremër: e zeza e vedit*

Folje + emër (+ emër): *asht kapak florin; me zan me preshe në dorë; qiella e toka me u ba bashkë; me ba mizën buell; vene dorën në zemër; flitej gojë me gojë; ka xanë rrota bishtin; i hini lepri në bark; e mban në shplakë të dorës; hasi sharra në gozhde; asht kapak florini; si qeni në rrush; kishte hupë si spata pa bisht; u zgjidh gjuhet; nuk e ka shkruet Zoti; lëvizin bishtin; mu xe gjaku; m' hini friga; u ka vdek nana; me qeshë nën mustak; pësojnë rrezikun e zi; nuk e pin at ujë; me i kalbë në burg; me ia ndigjue zanin; më mbysin në hu; qita pushkë; dalë zani; marrë nderën; dikush i bie thumbit e dikush patkoit; me i hi në hater; ua lashë tehin mbarë; ia prune të mirë; nuk e rrudhi gojën; na lshoi doret; por gjejmë edhe frazeologji me rend të kundërt: ditët i keni të numrueme; qiella e toka me u ba bashkë; etj.*

Sic vihet re kjo strukturë është tipike për pjesën më të madhe të frazeologjive të përdorura prej autorit. Kjo lidhet me qëllimin e veprës; të rrëfente atë që kishte parë, pra veprimi mbetet në themel të rrëfimit të autorit.

Folje + emër + mbiemër: *na hini frigë e madhe; ra ujët e valë; pësojnë rrezikun e zi;*

Folje + folje: *pa prit pa kujtue; me shpëtue kryet; me hek qafet; tërhiq e mos e këput; as e njoft as dij etj.*

Folje + ndajfolje: *ishin pa me hanë pisk; me i ba "mat"*

Folje + emër + ndajfolje: *ua lashë tehin mbarë; nuk e lëshonte gojet kurrë etj.*

Në planin semantik, sipas vlerës leksiko – gramatikore njësitë frazeologjike kanë kuptimin e përgjithshëm kategorial të fjalëve të cilat i plotësojnë. Duke u nisur nga përkimet kuptimore me pjesët e ligjëratës, këto njësi mund të jenë: emërore, mbiemërore, foljore, ndajfoljore. Këto njësi gjallojnë në leksik së bashku me pjesët e ligjëratës dhe shpeshherë e zëvendësojnë kuptimisht njëra-tjetrën dhe kanë funksion të njëjtë leksiko-gramatikor.

Njësi frazeologjike me kuptimin kategorial të emrit.

Frazeologjia në veprën e At Zef Pllumit

Në klasifikimin e frazeologjisë shqipe, sipas kuptimit leksiko- gramatikor, pra sipas përqasjes kuptimore me pjesët e ligjëratës, grup të veçantë përbëjnë njësitë frazeologjike emërore.¹

Njësitë frazeologjike të formuara me gjymtyrë emërore.

mos me kalu as miza; . nane e keqe; ujku me kater këmbë etj.

Njësitë frazeologjike me kuptimin kategorial të mbiemrit:

I rrahun në jetë; i djegun për ujë; në dritë të synit; gadi me i dalë shpirti; copë e leckë; si qeni në rrush; fukara i këputun; kapak florini; e mbramja birë e kavallit; si spata pa bisht; me u mbajtë mend; gazi i dheut; krye trashë; i veshun e mathun si krajl; si kau nën thikë; zdashun e zbathur; kishte mbaru me te tana; mos me iu gjet shoqja mbi tokë; nuk ka hy në jetë; në dritë të synit; nuk ka kalem që e kap; babë e mbi babë; as e njof as di; puntorë të qitun, me hager me lugë arit etj.

Njësi frazeologjike me kuptimin kategorial të foljes: *me e shprazë zemrën; na hini frigë e madhe; me shpëtue kryet; me hek qafet; ka gisht; nuk çajnë kryet; me ba mizen buell; i ra ujët e valë; i mora shpirtin; more vesht ti; nuk ia ndjeva ma zanin; e ka në dorë; me ta hanger kryet; e len në baltë; i hager fjalët; vene doren në zemer; një sy gjumë; vras mendjen; e pat edhe kjo jetë; nuk i flitej gojë me gojë; i hini lepri në bark; u thame prej eret; copë e leckë; pvetën e më sterpveten; si ta shofish të udhës; jam regjë; ma ven veshin; kishte hupë si spata pa bisht; me u mbajtë mend; u zgjidh gjuhet; merrshe veten në qafë; kishin vu në sy; me dorë në zemër; levizin bishtin; mu xe gjaku; m' hini friga; u ka vdek nana; me qeshë nën mustak; me i hanger kryet njani- tjetrit; qita pushkë; dalë zani; marrë nderën; me ua pa sherrin; dikush i bie thumbit e dikush patkoit; nuk e rrudhi gojën etj.*

Njësitë frazeologjike me kuptimin kategorial të përemrit: *për një fjalë goje; për pesë pare muhabet etj.*

Njësitë frazeologjike me kuptimin kategorial të ndajfoljes: *asnji hundë burrrnot; ndëmjet kullmës dhe çekiçit; qielli e toka me u ba bashkë; me iu dhimtë gurit e drunit; kanë dalë me bajrak; lashë tehin mbarë; pa çajre pa derman; zi e ma zi; pa prit e pa kujtue; pllammë për pllammë; gadi me i dalë shpirti; qiella e toka me u ba bashkë; me dorë në zemër; aty ku nuk të nxjerr as buelli; i veshun e mathun si krajl; çka i mbet mas shpirtit etj.*

Shumica e shprehjeve me strukturën e një fjalie kanë vlerën e fjalëve të urta: *s' hyn kungulli në vrimë të miut; i zoti e shet, tellalli s'e jep; s' ka trimni pa i cop marri; friga ka le para trimnisë; horrat duen horra; duhen oqiça me i pri tufës etj*

Sipas studiuesit Jani Thomai: "Gjithë funksionet e njësive frazeologjike mund t'i bashkojmë në dy grupe kryesore: funksione që lidhen me aftësinë shënuese dhe ato që lidhen me aftësinë vlerësuese. Në grupin e parë hyjnë njësitë frazeologjike që kanë aftësitë për të shënuar sende dukuri cilësi a veprime njësoj si fjalët, qoftë krahas këtyre, qoftë edhe më vete, e në këtë mënyrë ato mbushin zbrazëtinë e sistemit leksikor"²: që ishin zhdukë *pa nam pa nishan; u turr vrap; tua e pa se per tash ma nuk çante kryet kurrnji shqiptar; e lëshuen Tiranën; na hini frigë e madhe;*

¹ J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981, f. 74.

² J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 239.

po më duhet me ikë *pa prit pa kujtue; me shpëtue kryet*; ky nuk na lshon deri të vijë një tjetër *me hek qafe*; unë e njihshem vendin *pllamë për pllamë*; unë nuk *qita pushkë* për me më *dalë zani*; *dikush me dreqin e dikush me të birin*; ma pat marrë nderën para tan fisit; *ka gisht në këto punë*; Kta nuk çajnë kryet fare për ligje; ishin vetëm *“mish për top”*; Ia kish dalë *me ba mizen buell*; katolikët menduen *me ba vedin të gjallë*; ndërkaq *delte zani i zi*; *që t'i kapi t'i shtrojë në dru*; ku kishte *mâ në namë e në zâ*; u rrasën neper burgje së pari *“shpijat e mdha”* (fq. 73); *e mban në shplakë të dorës*; ne françeskanve na *ra ujët e valë*; Ha e pi *shka me don qefi*; *të zun më presh në dorë*; *mue më kishte kapë gazepi për me derdh ujë*; të dridhunat e mia i *ranë ne sy rojes*; fol o ta *mora shpirtin*; Unë nuk *dij lojna*, prandej fol; *u bjen pasha në gjû*; e pata *xan pëmendsh*; *more vesht ti*; për disa muej nuk ia *ndjeva ma zanin*; sot rinia e *ka në dorë*; nuk është *asnji hundë burrrnot* karshi shpenzimeve e sakrificave të klerit katolik; kam *shkri gjithë jetën* teme për popullin; ju keni *me ua pa sherrin* të parët; *Dikush i bie thumbit e dikush patkoit*; burrë shumë i mendshëm dhe i *rrahun në jetë*; *Ku të çon mushka*; flasin kundër fratit *per me i hi në hater partisë*; me të gjithëve *ua lashë tehin mbarë*; *me ta hanger kryet*; *ia prune të mire*; *e len në baltë*; ke me pa ti si ka me i *hager fjalët*; nuk e rrudhi *gojën*; *vene doren në zemer*; nuk e dinte se *ku vret fjala*; asht fëmijë, ende nuk ka *hy në jetë*; bane edhe ti *nji sy gjumë*; un vras *mendjen kot*; e pat edhe *kjo jete*; *flitej gojë me gojë*; na *ka xanë rrota bishtin* etj.

Në grupin e dytë hyjnë aftësitë e njësive frazeologjike për të vlerësuar sendet a veprimet nga ana emocionuese stilistike ose nga shprehësia, gjë që arrihet nga tema semantike, nga figura gjuhësore që ndërtohet, nga konteksti historike shoqëror i krijimit e përdorimit, sidomos nga ngjyrimi emocionues i veçantë³: *copë e zhel* në rrugë të madhe të madhe me lyp *nji copë buke*; nuk ishte njeri strikt i rregullave *porsi gjerman*; un' nuk *di me zie nji kokerr ve!*” ai vjen e më vret *në breg të votrës*; *e zeza e shpisë e zeza e vedit*; do të ishte *turp e faqe e zeze* para historisë etj.

sikur të shkojshin me u mbyt vetë *si berrat te kasapi*; gjendeshim si *delet brenda nji vathi të rrethuem prej ujqve të terbuem*; të pushkatuemët me i lanë ashtu *rrah per tokë*; arrestimi i tij *na vrau të gjithëve*; nuk do të kishin asnjë pasojë të keqe përveç atyne që kishin *la duert me gjak*; *gjithkujt i hini lepri në bark* e mendote veç si me shpëtu *vedin*; kam munds i me të shti aty ku nuk të nxjerr as buelli; i *veshun e mathun si krajl*; ky *stan ket bylmet ka*; revolucion i asht *nji ujkongjë që i han bijt e vet*; *mos t'i bahet barrë shoqit të vet*; por me at ciprianin *ishin pa me hanë pisk*; *kangëtar i lindur me nji za të ambël si bilbili*; *kjajshim vuajtjet*; por atë ditë *hasi sharra në gozhdë*; ishte kenë i *djegun për ujë*; fillova ulërimat *si kau nën thikë*; nuk më dukej se po më bjen ndër shpatulla, por *në dritë të synit*; e kishem *mulla në zemer*; puna asht se këta duen *me na qit faret*; *aty luente shkopi, dajaku, bishti i lopatës*; e shumta kishin mbetur *zdeshtun e zbathur*; turp për ju të tjerët që *keni lê me kazmë e lopatë në dorë*; dikur burrë i shëndoshë e i mbajtun, por që *tash ishte bâ âsht e lëkurë*; ishte kthye ne gjendje *gadi me i dalë*

³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 239.

shpirti; atje mbeten eshtnat e shokëve tanë; aty u thame prej erës; të gjitha andrrat çuet; udhëtim prej eksploratorësh; u çua, u avit dhe e përlau si ujë; të tjerat i kishem copë e leckë; më pvetën e më sterpveten; i gjalli ka dermanin; të gjithë shkojmë si qeni në rrush po nuk kje dikush me kallxue se si kje puna; fukara i këputun; herezi fund e maje; po ta la ty qamil, baj si ta shofish të udhës; vdekja me nder asht kapak flori; ma len atë punë se jam regjë për tri vjet; terhiq e mos e këput; e pashë edhe un se fjala kishte ec; po kush ma ven veshin; jam e mbramja birë e kavallit; mos të kaloje as miza pa e dijtë ju; kishte hupë si spata pa bisht; ia kish dalë me i ba “mat” Tuk Jakovës; kishte kërkue ndoren e tij e të Kelmenit; po u ndimonte me sa u kish mbet mas shpirtit; dimni që kalova atë vjet kje me u mbajtë mend; si me ken tu vra me karadak; ishte tepër heret per me u zgjidh gjuhet; livadhet e bjeshkëve, të mbulueme me borë, ishin akull një copet; fjalën që do të shqiptojshem; gjeta aq burri e bujari sa me t’u knaqë zemra; ky popull nuk kishte mbaru me te tana; mos me iu gjet shoqja ma sojnikë mbi tokë; mos ta merrshe veten në qafë; kishin vu në sy me pushkatue nderin e klerikut katolik; zoti na lshoi doret; nuk ka kalem që e kap; don me u ba gazi i dheut; e kishte kryet e trashë; ku me e gjet një fill më u kapë per me e shpëtu vajzen; qiella e toka me u ba bashkë un nuk rrij pa e marrë; nuk e ka shkruë zoti për ty; ai ishte babë e mbi babë; me dorë në zemër; kjan si fmi djepi; kishte një grua si djalli i fundiferit; mos ta levizin bishtin; ta pame sherrin te tan; mu xe gjaku; m’ hini friga; ende s’ke dalë prej shperngajsh; asht e fortë e shpi soji; ia han kryet vedit; atyne dokumentave që ke ti në dorë u ka vdek nana; me qeshë nën mustak; pësojnë rrezikun e zi; ditët i keni të numrueme; nuk e pin at ujë; ke hupë si kripa në ujë; ka nevojë me e shprazë zemrën; nuk e lshonte gojet kurrë; me i kalbë në burg; me ia ndigjue zanin; mos i merrni në qafë; më mbysin në hu; un as e njof as dij; sa me i hanger kryet njani- tjetrit etj.

Njësitë frazeologjike që kanë qenë dhe janë pronë e mbarë gjuhës që edhe pse dikur i përkisnin burimit krahinor sot ato përdoren si mbarëkombëtare. Duhet theksuar se pavarësisht kësaj ato përdoren në trajta fonetike krahinore: *me e shprazë zemrën; na hini frigë e madhe; pa prit pa kujtue; me shpëtue kryet; me hek qafet; pllammë për pllammë; ka gisht; nuk çajnë kryet; me ba mizen buell; e mban në shplakë të dorës; ra ujët e vale; shka me don qefi; me zan më preshe në dorë; qiella e toka me u ba bashkë i mora shpirtin; nuk dij lojna; me e xan pëmendsh; more vesht ti; nuk ia ndjeva ma zanin; e ka në dorë; i rrahun në jetë; ku të çon mushka; me ta hanger kryet; e len në baltë; i hager fjalët; vene doren në zemer; ku vret fjala; nuk ka hy në jetë; një sy gjumë; vras mendjen; e pat edhe kjo jete; flitej gojë me gojë; i ka xanë rrota bishtin; i hini lepri në bark; ky stan ket bylmet ka; kangëtar i lindur; hasi sharra në gozhdë; i djegun për ujë; në dritë të synit; gadi me i dalë shpirti; u thame prej erës; copë e leckë; pvetën e më sterpveten; si qeni në rrush; fukara i këputun; si ta shofish të udhës; asht kapak florin; jam regjë; tërhiq e mos e këput; ma ven veshin e mbramja birë e kavallit; mos të kaloje as miza; kishte hupë si spata pa bisht; me u mbajtë mend; u zgjidh gjuhet; merrshe veten në qafë; kishin vu në sy; nuk ka kalem që e kap; gazi i dheut; e kishte kryet e trashë; gjet një fill më u kapë; qiella e toka me u ba bashkë;*

nuk e ka shkrue Zoti; babë e mbi babë; me dorë në zemër; levizin bishtin; mu xe gjaku; m' hini friga; u ka vdek nana; me qeshë nën mustak; pësojnë rrezikun e zi; ditët i keni të numrueme; nuk e pin at ujë; si kripa në ujë; nuk e lshonte gojet kurrë; me i kalbë në burg; me ia ndigjue zanin; më mbysin në hu; as e njof as dij; me i hanger kryet njani- tjetrit etj.

Njësitë frazeologjike dialektore krahinore: *qita pushkë; dalë zani; dikush me dreqin e dikush me të birin; marrë nderën; asnji hundë burrrnot; shkri gjithë jetën; me ua pa sherrin; dikush i bie thumbit e dikush patkoit; me i hi në hater; ua lashë tehin mbarë; ia prune të mirë; nuk e rrudhi gojën; me të shti aty ku nuk të nxjerr as buelli; i veshun e mathun si krajl; mos t'i bahet barrë shoqit të vet; ishin pa me hanë pisk; si kau nën thikë; mulla në zemer; me na qit faret; aty luente shkopi, dajaku, bishti i lopatës; zdashun e zbathur; me i ba "mat"; kishte kërkue ndoren; mbet mas shpirtit; kishte mbaru me te tana; mos me iu gjat shoqja mbi tokë; na lshoi doret etj.*

Në veprën e At Zef Pllumit, gjejmë edhe variacione frazeologjike: *s'ke dale prej shperngajsh; ia han kryet vedit; fund e maje; ishte bâ âsht e lëkurë; mbeten eshtnat etj.*

Njësi frazeologjike që lidhen me emrin e dikujt a me një ngjarje historike: *si me ken tu vra me Karadak.*

Një vend të konsiderueshëm në veprën "Rrno vetëm për me tregue" zënë edhe frazeologjitë në gjuhën latine. Kjo lidhet me njohuritë e gjera të autorit në këtë fushë, por edhe me domosdoshmërinë e përdorimit të tyre për të përcjellë një realitet të paimagjinueshëm *Cartago delenda est (Kartagjena duhet të shkatërrohet); Nemmo Judeks i casa susa (kurrkush nuk mund të jetë gjykatës i vetvetes); Salvi ghi puo; modus Vivendi; Vaevictis etj.*

Njësitë frazeologjike, më shumë se fjala, nuk shërbejnë vetëm për të emërtuar, por edhe për të shprehur qëndrimin emocional, ndijimet vetjake shpesh jo vetëm autorit, por edhe të një grupi të caktuar individësh. Këto grupe janë shumë të larmishme, prandaj e tillë paraqitet edhe frazeologjia e At Zef Pllumit. Ngjyrimi emocional është i shumëllojshëm, por në këtë vepër mbizotëron qëndrimi ironik, përbuzës, dashamirës dhe i dhembshur përballë situatave absurde dhe të vështira dhe që i ofroi jeta e autorit dhe gjithë popullit tonë. Janë pikërisht këto situata, qëndrime emocionale dhe raporte të veçanta që përcaktojnë edhe frazeologjinë e përdorur. Duke u nisur nga mënyra e vendosjes dhe interpretimit të raporteve që krijohen në vepër, njësitë frazeologjike i ndajmë në:

1-Njësi frazeologjike me shumësi ngjyrimesh kuptimore dhe emocionale: sot jam 25 vjeçar, *në lulëzim të jetës* e nuk të la *me hî si të duesh* në jetën time; mos të qitët Zot *nder duert e tija* se ky ta ban gjamën; ne qesheshim per me largu të keq në *prakun e stuhisë; hini në lojë* ai vetë personalisht; *hin në punë, çil familje* e jeto si gjithë njerëzit; ishte ba *me tu dhimbtë; me hek qafet; më doli zani etj.*

2-Njësi frazeologjike me intensitet të lartë përforcimi: deri aty kish vojt puna: *me ia pas lakmi një të marri; mi lidhi duert pas shpine, jo sikur t' ishin duert njeriut apo kafshe së gjallë, por sikur të ishin dy copa druni; Kur bahet magjyp i pashë vret t'anë; një ëngjëll i derguem prej Zotit për me më ngushëllue; i kishte*

shërbye jo sikur Pater Pali t'ishte babai i saj, por *sikur të ishte një fëmijë i saj*; e *muer punen me gjoks*; sikur *më thershin veshte* ato "hohoho" të vazhdueshme të burrave; puna asht *sa me hager një kashatë bukë* etj.

Njësi të mbështetura te krahasimi kishte një grua *si djalli u fundiferit*; ke hupë *si kripa në ujë*; *si me ken tu vra me Karadak*; za të ambël *si bilbili*; nuk ishte njeri strikt i rregullave *porsi gjerman*; *vdekja si i lir*; i kishte shërbye jo sikur Pater Palit'ishte babai i saj, por *sikur të ishte një fëmijë i saj*; me të marrë bukën ishte barabar si me të marrë shpirtin; ishim *si ai mini që ka hì vetë në kurthat* e gjana ku ia mund të lëvizi gjallë, por s' ka nga del, Fratel Gjoni *më dhimbej në shpirt*: kishem fitue për të jo vete respekt, por një dashni *si ta kishem babe*; i veshun e *mathun si kraj*; ik ditën për diell si burrrat e jo naten *si hajdut i keq*; fjalët shkojshin tu nxjerrë njena – tjetren *porsi qershiat prej koshit*; i tërbuem *si ujk*; vena e rakia *derdheshin si lum*; i pëlqen të shkapetet në mur e të vllaçitet ndër çimentet e hetuesisë sikur të ishte sukull etj.

Frazeologjizma të mbështetura në metafora: *Ne nata na ka xanë e terrina*; janë njerzit që *i pjell koha e nevoja e njerzve*; kohëve t' ardhshme *do t'u flitshin vetëm ato copa letrash*; po filloi *me ba punen e vet kureshtja*; mbaj mend mirë se kur një natë hapëm letërkëmbimin e Luigj Gurakuqit për me bërë përzgjedhjen, ai tha: "shif djalë, sonte *jena tue zhdeshtë një te dekun!*"; e ndjeva vedin se ishem kurrëgjatë, por *një tullumbace në havâ* që sillet na atë drejtim që ta çojë era; o dashuni vetëm *ti duhet të sundosh botën*, vetëm ti mund *ti zbutish kafshët e egra*; Ish projekti i asaj *diplomacie botnore që i vret popujt si tufat e bagëtive*; kishte aftësi *gojtarie të shkathët e me kthesa* të një bukurie të rrallë, me kishte mbet vetem *një rreze shprese*; *ishin hapë shumë rrugë të lirisë*; ndërgjegjet tona janë të sigurta *nën ombrellën e lirisë*; *me pushkatue nderin*; etj.

Sinonimia në frazeologji

Njësitë frazeologjike krijojnë sinonimi, antonimi, homonimi njësi të tjera frazeologjike, njësoj si edhe fjalët. Frazeologjitë për shkak të formës dhe të karakterit, japin jo vetëm nuanca të holla kuptimore, por edhe mjaft impulsive dhe ekspresive gjë që nuk e arrin përmes sinonimeve. Kjo ndodh për shkak të ngjyrimin të fortë emocional dhe motivimit të duhur që zotërojnë frazeologjizmat që përdoren si mjete për shprehësinë e gjuhës, rezultat i cili nuk mund të arrihet nëpërmjet sinonimeve të cilat janë shpesh asnjënjësi. "Sinonimi ndërmjet njësisë frazeologjike kemi atëherë kur dy a më shumë njësi frazeologjike, kanë funksion sinonimie dhe kanë kuptim leksikor objektiv të afërt apo të njëjtë, por edhe ngjyrë emocionale a forcë shprehëse të njëjtë"⁴. Nga ana tjetër te frazeologjitë është "si karakteristikë e përgjithshme e tyre njëkuptimësia, ndryshe nga fjalët, shumica e të cilave kanë më shumë se një kuptim"⁵. Njësitë frazeologjike të konsideruara si ekuivalente me fjalët, nuk janë të barasvlershme me to në të gjitha kuptimet me to, por janë ë tilla për sa i përket funksionit të tyre në gjuhë. Duke u mbështetur në motivimin e frazeologjizmave, në karakterin figurative të përbërësve të tyre, në

⁴ Sh. Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985, f. 110.

⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2005, f. 180.

strukturën e brendshme dhe në ngurosjen e pjesëve përbërësve dhe të formës së ndërtimit, në frazeologjizmat e gjuhës shqipe ndeshim disa tipa: idiomat ose përngjitje frazeologjike, njësi frazeologjike dhe bashkime frazeologjike⁶.

Njësitë frazeologjike shpesh plotësojnë mungesën e fjalëve në leksikon e një gjuhe, kur mungon fjala e veçantë për ndonjë koncept të caktuar.

Nëse në frazeologji flitet për tipologji edhe në veprën e autorit Zef Pllumi mund të dallojmë disa tipa sinonimesh:

Njësi frazeologjike sinonimike me struktura që kanë dallime leksiko-gramatikore. Shpesh njësitë frazeologjike sinonimike të këtij grupi shpesh përbëhen nga struktura me madhësi të ndryshme, me zgjerim ose ngushtim kuptimi ose dalin si njësi që kanë si gjymtyrë variantin leksiko-gramatikor të një lekseme: *për një fjalë goje; për pesë pare muhabet; zdashun e zbathur; fukara i këputun; copë zhel; i hunit e litarit; asht e lëkurë; me iu dhimtë gurit e drunit; me i kalbë në burg; më mbysin në hu; ta ban gjamë; ta mora shpirtin; me ta hanger kryet; me mbeten eshtnat; pa nam pa nishan; hek qafet; ra ujët e vale; kishte mbaru me te tana; merrshe veten në qafë; pësojnë rrezikun e zi; ditët i keni të numruara; kishte hupë si spata pa bisht; ke hupë si kripa në ujë; e len në baltë; ke me pa ti si ka me i hager fjalët; na u lig ora; të paska kenë lag baroti; po kush ma ven veshin mue; jam e mbaramja birë e kavallit; e mban në shplakë të dorës; ha e pi shka me don qefi etj.*

Antonimia në frazeologji

Në përputhje me nevojat që ka gjuha për të plotësuar me mjetet e saj kërkesat e shoqërisë e të bartësve të saj, për të shprehur kundërvënien e sendeve, të dukurive, të vetive e cilësive të tyre të kundërta, përdor edhe togfjalësja frazeologjike, sepse shpesh këto njësi japin një ngjyrim emocional të caktuar, i cili nuk mund të shprehet me fjalë⁷. Për shkak të nuancave të stërholluara e të shumëllojshme me intensitetit më të ulët ose më të lartë kuptimor, këto njësi e kanë shkallën e kundërvënies më të dobët se fjala. Pra pikërisht antonimia frazeologjike nuk është e mirëfillta për shkak të karakterit të figurshëm të njësive frazeologjike dhe të ngjyrimit emocional e stilistik tyre. Në kohën kur jetoi autori, nëpërmjet antonimisë ka arritur të përcjellë anët e kundërta të jetës, tiparet dhe cilësitë e bashkëkohësve të tij, por edhe dilemat që lindnin në kushtet e rënda të jetës. Qëllimi i autorit siç e kemi theksuar është të tregojë, por një tregim aq rrëqethës siç është ai i jetës së një njeriu që jetoi nëpër burgjet komuniste, fjalët me ngarkesë emocionale e kuptimore burojnë jashtë çdo qëllimi letrar. Pavarësisht kësaj njësitë frazeologjike të veprës: “Rrno vetëm për me tregue” mund t’i grupojmë:

a-Njësi frazeologjike antonimike me ndërtim e gjymtyrë krejt të ndryshme. Në këto çifte antonimike të njësive frazeologjike, që përbëjnë edhe numrin më të madh, shërbejnë kuptimet e kundërta që bartin në vetvete këto njësi me gjymtyrë të ndryshme: *I veshun e mathun si krajl - copë e zhel në rrugë të madhe - me lyp*

⁶ Sh. Islamaj, vepër e cituar.

⁷ M. Samara, *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985, f. 163.

nji copë buke- ishte ba me tu dhimbtë etj. po kush ma ven veshin mue – burrë me na; jam e mbramja birë e kavallit; un as e njoftoj as di, -ku kishte mâ në namë e në zâ; u rrasën nëper burgje së pari “shpijat e mdha”; Ha e pi shka me don qefi; puna asht sa me hager një kashatë bukë; e mban në shplakë të dorës; menduen me ba vedin të gjallë - na ra ujët e vale, kishin me hager me lugë arit – ha si lypsar e tij; kam pas harrue shka asht vorfnia - tash tre- kater vjet edhe shëjtent do ma kishin lakmi

b- Njësitë frazeologjike antonimike me një gjymtyrë të përbashkët. Të gjitha këto çifte kanë një gjymtyrë të njëjtë e cila shërben si qendër antonimike e njësisë dhe luan rolin kryesor në realizimin e kundërvënies së kuptimeve që mbartin njësitë frazeologjike: *mos me iu gjet shoqja ma sojnikë mbi tokë* - ishte një grua si djalli u fundiferit, burrë shumë i mendshëm dhe i rrahun në jetë- ende nuk ka hy ne jetë etj.

Njësi frazeologjike antonimike, në të cilat kundërvënia antonimike shprehet me anë të pjesëzave mohuese s', jo, nuk, mos. Këto pjesëza hyjnë edhe në strukturën e njësisë, mund të qëndrojnë edhe të lira. Kuptimi mohues i njësisë frazeologjike është i lidhur me gjithë kuptimin e njësisë. Kjo kundërvënie është e pjesshme dhe nuk është e plotë, sepse ashtu sikurse kundërvënia e fjalëve bazuar në mohimin e kuptimeve të tyre, edhe kundërvënia e togfjalëshave të qëndrueshme, bazuar në mohimin e kuptimeve, mbetet e një e një shkalle mjaft të dobët. Antonimia e kuptimeve të njësisë frazeologjike e shprehet me pjesëza mohuese nuk është e mirëfilltë; sepse kundërvënia e atyre kuptimeve është mjaft e dobët, është një kundërvënie togfjalëshore e një natyre tjetër, që bazohet në mohimin sintaksor⁸. Autori i përdor këto tip kundërvënies kur antonimia nuk mund të shprehet me një fjalë të vetme. Ato janë të tipit: *ia prët mendja- nuk ia prët mendja; ma vun veshin – nuk ma vun veshin; hoqi dorë – nuk hoqi dorë; e kishem në dorë – nuk e kishem në dorë*; Pra, shumica e njësisë frazeologjike antonimike janë të pamotivueshme ose më pak të motivueshme.

BIBLIOGRAFI

- Atë Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, Tiranë, 2006.
J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999.
J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë 2006.
J. Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, 2001.
M. Samara, *Çështje të antonimisë në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1985.
R. Carter (1998), *Vocabulary - Applied Linguistic Perspectives* (2nd ed.). New York: Routledge.
R.W. Gibbs, *What do idioms really mean?* IN: *Journal of memory and language*, 1992, Vol.31, pp.485-506.
Sh. Islamaj, *Çështje të sinonimisë në gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1985.

⁸ M. Samara, po aty, f. 171.

